

KËRKESË
Nr.1390/5, datë 25.4.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për të gjitha pasuritë që figurojnë në listën ku janë pasqyruar sipërfaqet respektive që preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor, është bërë shënimi “Proces rikonfirmimi dhe saktësimi”, për arsye të të dhënave të pasakta dhe jo të plota, konfirmuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë (ZRPP).

Për pasuritë për të cilat pronari figuron i paidentifikuar, personat që pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, si dhe të paraqesin një kopje të dokumentacionit përkatës pranë MPPT-së, pasi nuk disponojnë të dhëna lidhur me pronarin.

Për objektet është bërë shënimi “Proces rikonfirmimi”, për arsye se do të rikërkohet konfirmim pranë ALUIZNI-t Tiranë, si dhe pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë (ZRPP).

Ju bëjmë me dije se në bazë të të dhënave që do të konfirmohen nga institucionet e sipërpërmendura, si dhe nga informacionet që do të mblidhen në terren, do të hartohen listat përfundimtare të cilat do të propozohen për shpronësim pranë Këshillit të Ministrave.

Lutemi qytetarëve, të cilët pretendojnë pronësinë, mbi objektet të cilat nuk janë përfshirë në procesin e legalizimeve apo nuk janë të regjistruara pranë ZRPP-së, të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë kësaj zyre, si dhe të paraqesin pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dokumentacionin tekniko-ligjor (nëse disponojnë të tillë), nëpërmjet të cilit vërtetojnë titullin e pronësisë mbi këto objekte.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 739 864 128 (shtatëqind e tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Ollashi